# AKTIVITETE VERE PER ADOLESHENTET

Adoleshenti juaj me zor i pret pushimet e veres. Por si perfundon duke e kaluar kohen? Sigurisht, me ore te tera perpara ekraneve. E c'eshte me e keqja, nuk gjeni kurre kohe per te shpenzua si familje. Por faktori qe eshte me bollek gjate kesaj stine eshte KOHA. Ndaj sfidojini ekranet duke u ofruar aktivitete argetuese ku te merrni pjese familjarisht dhe kaloni nje kohe argetuese te mrekullueshme me adoleshentin tuaj, duke forcuar keshtu edhe lidhjen tuaj me te!



# AKTIVITETE VERE PER ADOLESHENTET

## 1 PUNE OSE BIZNES I VOGEL

Mund te filloje te shese dicka qe ai prodhon vete (sado e vogel apo jo-fitimprurese te jete). Ndoshta edhe te nise nje pune part - time. Do te mesohet me punen, rendesine e saj, komunikimin me njerez dhe sigurisht, do te vleresoje dhe studimet ndryshe



## 2 PIKNIK NE NATYRE



Ku ka gje me te bukur se te kaloni kohe sebashku ne natyre? Merrni nje shtroje, ushqime dhe shume lojra me vete. Nese adoleshenti juaj nuk shkeputet nga telefoni, jini ju te paret qe lini telefonin tuaj menjane dhe ftojeni te beni sa me shume lojra sebashku

## 3 PLAZH OSE PISHINA

Jo vetem per argetimin qe sjell plazhi ne vetvete, por provni edhe lojrat e ujit. Jane aktivitete fantastike per adoleshentet; jetski, kanoe, merrni nje varke me qera apo beni nje nga turet me varka qe ofrojne agjencite e ndryshme



## 4 DITA E "PO"



Nje here ne sa dite, krijoni diten ku i thoni vetem "po" adoleshentit tuaj. Rregulli i arte eshte "TE JENI BASHKE". Pra nese ai do te haje akullore per mengjes, do hani sebashku akullore. Nese do te luaje playstation, do luani bashke. Eshte mundesi fantastike qe te lidheni sebashku

## 5 PROVONI GJERA TE REJA

Nje restorant i ri, nje ushqim i ri, nje destinacion i ri, nje sport i ri, nje aktivitet i ri. E rendesishme eshte te provoni dicka te re sebashku. Kjo pervoje do te forcoje me shume lidhjen tuaj



## 6 LUANI ME KAFSHE



Loja me kafshe sjell shume qetesim dhe te ploteson me ndjenje dashurie. Merrni adoleshentin tuaj dhe shkoni ne nje ferme (ka shume sot). Luani sebashku me qenushet apo delet, kecat, kuajt, etj. Me besoni qe do ndikoje shume ne mendjen e tij

# AKTIVITETE VERE PER ADOLESHENTET

## 7 MESONI NJE INSTRUMENT

Patjeter qe adoleshenti juaj preferon nje instrument. Piano, kitarre, violine, ka shume variacione. Ka gjithashtu edhe shume kurse qe ofrojne mesime te tyre. Eshte pervoje fantastike. Mos e neglizhoni.





## 8 MESONI LOJRA ME LETRA

Eshte nje aktivitet argetues, qe nuk kushton, e mbi te gjitha ku ju mund te kaloni kohe sebashku. Nese as ju nuk dini lojra me letra, mos u shqetesoni! Hapni youtube dhe voila!

## 9 KAMPING

A ka aventure me te paharrueshme se sa te flesh ne natyre? Ndoshta mund te merrni dhe ndonje mik tjeter te adoleshnetit tuaj. Hiking, eksplorim natyre, biseda dhe lojra pafund, ushqim rreth zjarrit. Argetuese per gjithe familjen, apo jo?





## 10 PROJEKTE DIY

Nga ndërtimi i pajisjeve te kopshtaria, projektet DIY mund të jenë edhe argëtuese edhe edukative.

## 11 MESONI NJE AFTESI TE RE

Nje aftesi cfaredo! Gatimi, piktura, skulptura, qendisja, kodimi, instrumenti muzikor, rregulimi i kepuceve, nuk ka asnje kufi, asnje limit ky mesim. Ama cfare aftesie dhe vetebesimi qe fitonadoleshenti ne fund!

